

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2022

Lënda : Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj dt 17.10.2022 ardhur në postën elektronike :

Pyetje dt.17.10.2022

Korporata Elektroenergjitike ka marrë persiper te mbaje të informuar opinionin publik mbi situatën në Kaskadën e Drinit, duke përditesuar të dhënat e nivelit të ujit, prurjeve, prodhimit ditor dhe rezervën energjitike. Postimi i fundit mbi këto të dhëna të plota ka qënë data 19 shtator, ndërkohë që në datën 11-12 Tetor 2022 janë publikuar në faqen e KESH vetëm të dhënat e prurjeve.

Përse KESH nuk përditëson të dhënat e kaskadës së Drinit, sikurse është zotuar?

Përgjigje sqaruese nga KESH sh.a. dt.27.10.2022:

Publikimi i të dhënave për nivelet e Kaskadës nuk është detyrim ligjor. Përditësimi i tyre me qëllim informimin e publikut kryhet kur në kaskadë ka evente sinoptike të rëndësishme ose në të kundërt thatësirë të tejzgatur. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndryshime të mëdha në nivelet e liqeneve të Kaskadës, që prej fillim shtatorit. Sot niveli i Fierzës është në kuotën 269 m.m.n.d.

Faleminderit!